



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr.1005/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit “ARTMOTION” SH.P.K., me NUI:810200866 me seli në Prishtinë, Zona Industriale, rruga e “Pejës”, kundër debitorit “ISP Broadcast” SH.P.K., me NUI:810011643, me seli në Prishtinë, rruga “24 Maji” nr.46-1, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.861/23 të datës 14.06.2023, të Përmbartuesit Privat Isa Gacaferi, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 19.10.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “ISP Broadcast” SH.P.K., ANULOHET Urdhri Përmbartimor P.nr.861/23 i datës 14.06.2023, i Përmbartuesit Privat Isa Gacaferi, dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka caktuar urdhrin P.nr.861/23 të datës 14.06.2023, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës Nr.F23-06-0001032 të datës 01.06.2023, Faturës Nr.F23-05-0000848 të datës 01.05.2023, Faturës Nr.F23-04-0001189 të datës 01.04.2023, Faturës Nr.F23-03-0001336 të datës 01.03.2023, Faturës Nr.F23-02-0001217 të datës 01.02.2023, Faturës Nr.F23-01-0001464 të datës 01.01.2023, me të cilin e ka detyruar debitorin që në emër të përmbartjes së obligimeve nga faturat më sipër, t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 88,500.00 €, me kamatën referente si pjesë e kamatës ligjore, nga data kur kërkesa është bërë e arritshme e deri me pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, nën kërcënimin e përmbartimit me dhunë, me bartjen e mjeteve financiare nga llogaria bankare e debitorit në llogarinë e veçantë bankare të kreditorit, me regjistrimin, konfiskimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme në pronësi të

debitorit dhe pagesën e borxhit nga shitja e këtyre sendeve deri sa të kryhet tërësisht obligimi i të njëjtit ndaj kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor duke theksuar se urdhri përmbartimor është i kundërligjshëm, pasi që asnjë nga faturat të cilat i janë bashkëngjitur propozimit për përmbartim, nuk janë pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori. Tutje ka shtuar se nuk ekziston asnjë dëshmi, që këto fatura janë pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, nuk janë nënshkruar nga debitori, si dhe nuk janë konfirmuar nga ana e këtij të fundit se të njëjtat i pranon. Po ashtu ka theksuar se kreditori, i ka bashkëngjitur urdhrin për përmbartim një dokument në gjuhën angleze, të titulluar Customer-Detail Trial Bal, i cili është një lloj ekstrakti të gjendjes së debitorit, i përgatitur nga kreditori, si rrjedhojë ky dokument nuk mund të shërbej si dokument i besueshëm në bazë të së cilit mund të iniciohet propozimi për përmbartim. Sa i përket komunikimeve elektronike, debitori në prapësim ka shtuar se, në komunikim e datës 09.05.2023, debitori e ka njoftuar kreditorin se nuk janë duke u përmbushur detyrimet kontraktuale në mes palëve, si dhe krejt në fund e ka njoftuar të njëjtin se, i kundërshton faturat e nisura një anshëm nga kreditori, për faktin se nuk ka marrë shërbimet sipas marrëveshjes ndërmjet palëve. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorit dhe të anulohet Urdhri Përmbartimor P.nr.861/23 i datës 14.06.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Isa Gacaferi, si dhe të detyrohet kreditori t'ia paguaj shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Kreditori në përgjigje në prapësim, ka deklaruar se e konteston në tërësi si të pabazuar prapësimin e parashtruar nga debitori për arsye se përmbajtja e prapësimit nuk përmbush asnjërin nga kushtet sipas LPP-së, ngase urdhri është mbështetur pikërisht në dispozitën në të cilën debitori ka ushtruar prapësim, përkatësisht nenin 29 par.3 të LPP-së. Tutje ka shtuar se dërgimi i faturave është bërë në ne pajtim me nenin 17 të LPP-së, si dhe nenin 99 par.1 dhe nenit 103 paragrafi.2 të LPK-së, mbi këtë bazë kreditori i ka dërguar debitorit përmes email adresës të gjitha faturat mbi baza mujore. Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet si i pa themeltë dhe i pa bazuar prapësimi i debitorit, ndërsa Urdhri Përmbartimor P.nr.861/23 i datës 14.06.2023, të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigja në prapësim, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që

gjenden në shkresat e lëndës, si dhe duke i'u referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet dhe procedura përmbartimore të përfundohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbartim, nuk i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 paragrafit 1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”* dhe me paragrafin 3 të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumentet Fatura Nr.F23-06-0001032 e datës 01.06.2023, Fatura Nr.F23-05-0000848 e datës 01.05.2023, Fatura Nr.F23-04-0001189 e datës 01.04.2023, Fatura Nr.F23-03-0001336 e datës 01.03.2023, Fatura Nr.F23-02-0001217 e datës 01.02.2023, , Fatura Nr.F23-01-0001464 e datës 01.01.2023, në bazë të së cilave është lejuar propozimi për përmbartim nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se faturat në rastin konkret janë lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk janë pranuar nga debitori, përkatësisht nuk përmbajnë nënshkrimin e as vulën e pranuesit - debitorit dhe nuk ka dëshmi se të njëjtat janë pranuar nga debitori.

Duke qenë se debitori nuk ka pranuar në mënyrë të rregullt faturat e lartcekura, si të tilla nuk mund të shërbejnë si dokumente të besueshme dhe nuk kanë tipare të përmbartueshmërisë, përderisa njëra palë procedurale - debitori nuk ka pranuar një detyrim që rrjedh nga fatura.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e kreditorit në përgjigje në prapësim se faturat janë dërguar në mënyrë elektronike - përmes email, mirëpo nga komunikimet elektronike rezulton se të njëjtat janë kundërshtuar nga ana e debitorit dhe si të tilla, nuk mund të konsiderohen se janë pranuar në mënyrë të rregullt, meqenëse debitori i ka kundërshtuar të njëjtat.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumentet e besueshme, mbi të cilat mbështetet propozimi për përmbaram, e mbi bazën e të cilave përmbaruesi privat ka lejuar përmbaramin, nuk kanë tipare të përmbarueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundohet në tërësi.

Gjykata në kuptim të nenit 71 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1005/23, datë 19.10.2023

Gjyqtarja

Verona Dibra

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.